

SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA

KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI

GSK-KPA-A-207/11

Prishtinë
31 maj 2012

Në çështjen e

I.I.

Paraqitësi i kërkesës/Pala ankuese

Kundër

Komunës së G.

Të përfaqësuar nga

H.H.

Pala përgjegjëse në kërkesë/Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët: Anne Kerber, kryetare e kolegjit, Elka Filcheva-Ermenkova dhe Sylejman Nuredini, anëtarë, duke vendosur me ankesën ndaj vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/116/2011 (lënda është regjistruar në AKP me numrin KPA00052), të datës 22 qershor 2011, dhe KPCC/D/C/118/2011 (lënda është regjistruar në AKP me numrat KPA00053, KPA00054 dhe KPA00055), të datës 22 qershor 2011, pas seancës së mbajtur 31 maj 2012, mori këtë

AKTGJYKIM

- 1- Refuzohet ankesa e I.I. si e pa bazuar.
- 2- Vërtetohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore i Kosovës KPCC/D/R/116/2011, i datës 22 qershor 2011, që referohet për lëndën e regjistruar me numrin KPA00052, dhe vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore KPCC/D/C/118/2011, po ashtu i datës 22 qershor 2011, që referohet për lëndën e regjistruar me numrat KPA00053, KPA00054 dhe KPA00055.
- 3- Obligohet pala ankuese që të paguaj shpenzimet e procedurës në shumën prej 530 € (pesëqind e tridhjetë euro) në Buxhetin e Kosovës brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

Më 5 maj 2006, I.I. ka paraqitur katër kërkesa në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), ku ka kërkuar vërtetimin e të drejtave të shfrytëzimit, ri-posedimin dhe kompensim për përdorim të paligjshëm të ngastrave të ndryshme.

GSK-KPA-A-207/11 (KPA00052):

Në këtë rast paraqitësi i kërkesës kërkon të drejtën e shfrytëzimit të pronës për një shtëpi ose banesë në këtë shtëpi, që ndodhet në ngastrën nr. 754 dhe 752, shtëpi me 6 dhoma dhe më sipërfaqe prej 165 m², e ndërtuar në vitin 1953, dhe oborr me sipërfaqe prej 5 ari e 65, që ndodhët në Gllogoc, rruga Marshal Tito no. 2 (vendi i quajtur “Arat e Ibrit”). Paraqitësi i kërkesës ka pohuar se hapësira ishte uzurpuar nga Komuna e G.. Ai po ashtu ka kërkuar kompensim për periudhën prej “1989-1999” deri me tani në shumën prej 10 milion euro.

Për të mbështetur kërkesën e tij, ai ka paraqitur në AKM përveç tjerash dokumentet në vijim:

- Fletën poseduese nr. 87, të datës 6 shkurt 2001, që tregon se Komuna e G. kishte qenë posedim të ngastrave nr. 752 dhe 754 në vendin e quajtur “Arat e Ibrit”;
- Fletën poseduese nr. 87 e datës së vitit 2000, që tregon se I.I. kishte qenë shfrytëzues i përhershëm i shtëpisë/banesës nr. 2, pronë në pronësi shoqërore të Komunës së G.;
- Aktgjykimi C. nr. 860/75 dhe 79/76 të Gjykatës Komunale të Prishtinës, që tregojnë se paraqitësi i kërkesës i kishte fituar dy rast të ndryshme lidhur me banesën nr. 2 kundër Komunës së G..

GSK-KPA-A-208/11 (KPA00053):

Paraqitësi i kërkesës kërkon të drejtën e shfrytëzimit të pronës për një shtëpi që gjendet në “Ashnajk zona B” në Glllogoc, të cilën supozohet se ai e kishte fituar me aktvendimin e Gjykatës Supreme të Datës 14 mars 1988. Ai kërkon të drejtën e posedimit dhe shfrytëzimit të përhershëm të kësaj prano, respektivisht objektit të saj dhe kompensim në shumën prej 20 milion euro.

Paraqitësi i kërkesës ka paraqitur në AKP vendimin nr. 6/89, më të cilin kërkesa e tij ekzekutimin e vendimit nr. 335/88 ishte aprovuar. Ai po ashtu ka paraqitur aktgjykimet e lartpërmendura të Gjykatës Komunale të Glllogocit.

GSK-KPA-A-209/11 (KPA00054):

Paraqitësi i kërkesës kërkon të drejtën e shfrytëzimit për një banesë me sipërfaqe prej 21 m², të fituar me vendimin e Komunës së G. të datës 2 dhjetor 1990. Ai ka deklaruar se e kishte fituar kontestin gjyqësor në vitin 1987 për një avokaturë dhe kërkon kompensim për 42 m² të cilat ai nuk është lejuar t'i shfrytëzojë për avokaturën e tij deri me 25 prill 2005 në shumën prej 50 milion euro.

Paraqitësi i kërkesës ka paraqitur në AKP ndër të tjera vendimin nr. 1191/87 të gjykatës Supreme të Kosovës më të cilin ishte aprovuar kërkesa e tij kundër Komunës së G..

GSK-KPA-A-210/11 (KPA00055):

Paraqitësi i kërkesës kërkon ri-posedimin e ngastrës prej 42 m² që ndodhet në “Zonën B” në Glllogoc e destinuar për avokaturë si dhe kompensim në shumën prej 60 milion euro për periudhën kohore nga viti 1989 deri në ditën e paraqitjes së kërkesës. Ai pohon se e kishte fituar të drejtën e shfrytëzimit me vendimin e Gjykatës Supreme nr 1449/88 të datës 8 nëntor 1988. Ai ka paraqitur në AKP në AKP ndër të tjera këtë vendim.

Me shkresën e datës 8 shtator 2008, paraqitësi i kërkesës ka deklaruar se prona të cilën e kërkon është marrë nga Komuna e G. gjatë “periudhës diskriminuese ndërmjet viteve 1989-1999”. Me shkresën e muajt maj 2009, ai ka konfirmuar se Komuna e G. e kishte uzurpuar pronën e tij dhe se po ndërtonte shtëpi të reja të paligjshme. Ai ka deklaruar se e kllithe fituar të drejtën pronësore në atë pronë duke e pasur atë posedim në mirëbesim që nga viti 1973.

Gjatë notifikimit të ngastrave ishte i pranishëm avokati H.H.. Më pasi, ia paraqiti përgjigjet me shkrim për kërkesat si përfaqësues i Komunës së G.. Ai ka pohuar se kërkesat duhet të hedhën poshtë pasi që janë jashtë juridiksionit të AKP-së dhe pasi që kontesti rreth pronave të kërkuara daton qysh nga viti 1974. Për më tepër, AKP-ja nuk ka pasur juridiksion që të vendos rreth kërkesave për kompensim.

Më 22 qershor 2011, AKP-ja me vendimet e saj KPCC/D/R/116/2011 (që i referohet kërkesës nr. KPA00052) dhe KPCC/D/C/118/2011 (që i referohet kërkesës nr. KPA00053, KPA00054 dhe KPA00055) i ka hedhur poshtë kërkesa pasi që ato nuk bien në juridiksion të KPCC.

Të dy vendimet i janë dorëzuar paraqitësit të kërkesës më 8 nëntor 2011. Më 16 nëntor 2011, paraqitësi i kërkesës (tash e tutje: pala ankuese) ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme lidhur me lëndët KPA00049 (e cila nuk është çështje në këtë aktgjykim të Gjykatës Supreme) dhe KPA00052 deri në KPA00055. Pala ankuese ka insistuar që lënda e tij të vendoset në favor të tij. Ai ka potencuar vërtetimin e gabuar të fateve dhe keqzbatimin serioz të ligjit. Ai insiston në kthimin e së drejtës së tij për kompensim që dëmin që ka rrjedhur nga periudha diskriminuese prej vitit 1989 deri në vitin 1999.

Ankesa i është dorëzuar përfaqësuesit të palës përgjegjëse në kërkesë (tash e tutje: pala përgjegjëse në ankesë), por ai megjithatë nuk ka reaguuar.

Gjykatat Supreme i ka bashkuar kërkesat.

Arsyetim ligjor:

Ankesa është e pranueshme. Ajo është paraqitur brenda afatit prej 30 ditëve të paraparë me neni 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079.

Megjithatë, ankesa është e pabazuar. Lëndët nuk janë në juridiksion të KKPK-së.

Sipas nenit 3.1 Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, paraqitësi i kërkesës ka të drejtë në një urdhëresë nga Komisioni për ri-posedim të pronës nëse paraqitësi i kërkesës jo vetëm që dëshmon pronësinë e pronës së paluajtshme private, por edhe që ai nuk është në gjendje aktualisht t'i ushtrojë këto të drejta pronësore për shkak të rrethanave që ndërlidhen drejtpërsëdrejti apo rezultojnë nga konflikti i armatosur që ka ndodhur në Kosovë ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.

Megjithatë, në këtë rast, paraqitësi i kërkesës nuk ka dëshmuar se humbja e pronës ka ndonjë lidhje me konfliktin e armatosur të vitit 1998/1999. Më sa duket, kontesti ndërmjet paraqitësit të kërkesës dhe Komunës së G. ka ekzistuar së paku qysh nga viti 1975, gjatë të cilit është lëshuar vendim i parë gjyqësor. Vendimi i fundit i Gjykatës Supreme është i vitit 1988. Pala ankuese e konfirmon këtë vlerësim me ankesën e tij, pasi që ai insiston në të drejtën e tij për kompensim të dëmit të shkaktuar gjatë “periudhës diskriminuese prej 1988 deri më 1999”. Kjo tregon qartë se konteksti nuk është i ndërlidhur me konfliktin e armatosur në vitin 1998/1999.

Megjithatë, KKPK-ja nuk ka për detyrë që të vendos rreth kontesteve që nuk janë të ndërlidhura me konfliktin e armatosur.

Shpenzimet e procedurës:

Në përputhje me Shtojcën III, nenin 8.4 të Urdhëresës Administrative (UA) 2007/5 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, palët përjashtohen prej shpenzimeve të procedurës para Sekretarisë Ekzekutive dhe Komisionit.

Ndërkaq një përjashtim i tillë nuk parashikohet në procedurën para Kolegjit të Apelit. Rrjedhimisht, regjimi normal i shpenzimeve gjyqësore siç parashihet me Ligjin mbi Taksat Gjyqësore (Gazeta Zyrtare e KSAK, 3 tetor 1987) dhe sipas UA nr. 2008/2 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi Unifikimin e Taksave Gjyqësore, zbatohet ndaj procedurës së zhvilluar para Kolegjit të Apelit.

Prandaj, shpenzimet gjyqësore si në vijim aplikohen në procedurën e tanishme të ankesës:

- Taksa nga tarifa gjyqësore për paraqitjen e ankesës (Neni 10.11 i UA 2008/2): 30 €
- Taksa nga tarifa gjyqësore për marrjen e aktgjykimit (Nenet 10.21 dhe 10.1 të UA 2008/2), duke pas parasysh se vlera e pronës në fjalë më arsye mund të vlerësohet deri në 100.000 €: 500 € (50 + 0,5% e 100.000) por jo më shumë se 500 €).

Këto tarifa gjyqësore duhet të merren përsipër nga pala ankuese që ka humbur rastin. Në përputhje me nenin 45të Ligjit mbi Shpenzimet Gjyqësore, afati për pagesën e taksave në fjalë 15 (pesëmbëdhjetë) ditë e më i gjatë se 90 (nëntëdhjetë) ditë. Neni 47.3 parasheh se në rast se pala nuk i paguan taksat brenda afatit të dhënë, atëherë bëhet zbatimi i detyrueshëm i pagesës.

Këshillë juridike

Sipas nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet me mjeteve të rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike.

Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, EULEX

Elka Filcheva-Ermenkova, Gjyqtare e EULEX-it

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Urs Nufer, Referent i EULEX-it